



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 179

Tiranë – E premte, 30 dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 88/2022, datë 22.12.2022	Për zgjedhjen e zonjës Gentiana Sula kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit..... 23321
Vendim i Kuvendit nr. 89/2022, datë 22.12.2022	Për zgjedhjen e zonjës Erjola Sadushi anëtare e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë 23321
Vendim i Kuvendit nr. 90/2022, datë 22.12.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 55/2014, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave”, i ndryshuar..... 23321
Vendim i Kuvendit nr. 91/2022, datë 22.12.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kuvendit nr. 98/2014, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”, i ndryshuar..... 23324
Vendim i Kuvendit nr. 92/2022, datë 22.12.2022	Për emërimin e zonjës Marjana Semini anëtare e Gjykatës Kushtetuese..... 23326
Vendim i Kuvendit nr. 93/2022, datë 22.12.2022	Për mosmiratimin e kandidaturës së zotit Altin Goxhaj për Avokat të Popullit..... 23326
Vendim i Kuvendit nr. 94/2022, datë 22.12.2022	Për mosmiratimin e kandidaturës së zotit Ledio Braho për Avokat të Popullit..... 23326
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 895, datë 29.12.2022	Për një ndryshim në vendimin nr. 465, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e task-forcës për përmirësimin e nivelit të kontrollit të mjeteve motorike e rimorkiove të tyre”, të ndryshuar 23327

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 896, datë 29.12.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga sheshi Shqiponja–Bulevardi i Ri” dhe “Rikualifikimi i unazës lindore për lotët 4, 5, 6” (faza 2)	23327
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 897, datë 29.12.2022	Për mbështetje financiare të menjëhershme të pensionistëve për zbutjen e impaktit të krizës.....	23332
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 898, datë 29.12.2022	Për mbështetje financiare të menjëhershme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik për zbutjen e impaktit të krizës.....	23333
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 899, datë 29.12.2022	Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e impaktit të krizës.....	23334
	Bibliografia e informacionit të deklasifikuar “Sekret shtetëror” në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave.....	23335

**VENDIM
Nr. 88/2022****PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS
GENTIANA SULA KRYETARE E
AUTORITETIT
PËR INFORMIMIN MBI
DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË
SHTETIT**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 8, pika 3, të ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e 28 deputetëve,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Gentiana Sula zgjidhet Kryetare e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 22.12.2022

**VENDIM
Nr. 89/2022****PËR ZGJEDHJEN E ZONJËS ERJOLA
SADUSHI ANËTARE E BORDIT
TË ENTIT RREGULLATOR TË
ENERGJISË**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të nenit 11 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe të nenit 111 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Zonja Erjola Sadushi zgjidhet anëtare e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë.
II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 22.12.2022

**VENDIM
Nr. 90/2022****PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN E KUVENDIT
NR. 55/2014****“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT
TË POZICIONEVE TË PUNËS TË
INSPEKTORATIT TË LARTË TË
DEKLARIMIT
E KONTROLLIT TË PASURIVE DHE
KONFLIKTIT TË INTERESAVE”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 16, pika 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, me propozimin e Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

- I. Miratohen ndryshimet në strukturë, organikë dhe klasifikimin e pagave të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit e Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.



II. Organika dhe klasifikimi i pagave të personelit është sipas lidhjes nr. 1 bashkëlidhur këtij vendimi.

III. Struktura organizative është sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.


IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 22.12.2022

Lidhja nr. 1

Struktura Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave





Lidhja nr. 2

ORGANIKA DHE NUMRI I PUNONJËSVE TË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT E KONTROLLIT TË PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE

(Struktura, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës janë miratuar sipas vendimit të Kuvendit nr. 55 datë 31.7.2014, ndryshuar me vendimin e Kuvendit nr. 71/2015, nr.108/2015 dhe nr.48/2016)

<u>Funksioni</u>	<u>Nr. i punonjësve / Kategoria/klasa</u>	
I. Inspektori i Përgjithshëm	1	Ligj nr. 9584/2006
II. Kabineti		
Drejtor Kabineti	1	II-a
Këshilltar	1	II-b
Sekretar i Inspektorit të Përgjithshëm	1	VKM
III. Sekretari i Përgjithshëm	1	I-b
IV. Inspektorë		
Inspektorë	28	II-a
Ndihmësinsektorë	12	II-b
V. Drejtoria Juridike dhe e Marrëdhënieve me Institucionet		
Drejtor	1	II-b
V/1. Sektori i Marrëdhënieve me Autoritetet Përgjegjëse		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	3	III-b
V/2. Sektori i Këshillimit Juridik		
Specialistë	2	III-b
VI. Drejtoria e Informacionit dhe Teknologjisë		
Drejtor	1	II-b
VI/1. Sektori i Zhvillimit dhe Mirëmbajtjes së Infrastrukturës		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialist	3	III-b
VII. Drejtoria e Financës dhe Administrimit		
Drejtor	1	II-b
VII/1. Sektori i Protokoll-Arkivit dhe Administrimit të Deklaratave të Pasurisë		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialistë	5	III-b
VII/2. Sektori i Administrimit të Financë-Buxhetit		
Përgjegjës sektori	1	III-a
Specialist finance	1	III-b
Specialist buxheti	1	III-b
Magaznier	1	VI
Shofer	2	IV
Receptionist	1	III
Sanitare	2	I
Gjithsej	73 punonjës	



VENDIM
Nr. 91/2022

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN E KUVENDIT

NR. 98/2014

“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS,
ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT
TË POZICIONEVE TË PUNËS TË
KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN
E SHËRBIMIT CIVIL”, I NDRYSHUAR

VENDOSI:

I. Lidhjet nr. 1 dhe nr. 2 të vendimit të Kuvendit nr. 98/2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil” ndryshohen sipas lidhjeve nr. 1 dhe nr. 2 bashkëlidhur këtij vendimi.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


KRYETARE
Lindita Nikolla

Miratuar në datën 22.12.2022

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 2, dhe 10, pika 1, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pika 4, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozim të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

Lidhja nr.1

ORGANIKA E KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL





Lidhja nr. 2

STRUKTURA E KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Funksioni	Nr. Punonjës	Kategoria
Komisioneri	1	Ligj nr. 9854, dt 17.07.2006 Vendimi 98/2014.
Kabineti	(2)	Vkm 187, dt 8.3.2017
Këshilltar	1	II- b
Sekretar	1	
Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes	(21)	
Drejtor i Përgjithshëm	1	II- a
Drejtoria e Inspektimit dhe Hetimit Administrativ	(7)	
Drejtor	1	II- b
Inspektor	6	III- a
Drejtoria e Mbikëqyrjes	(7)	
Drejtor	1	II- b
Inspektor	6	III- a
Drejtoria e Zbatimit të Vendimeve Paralajmëruese dhe Koordinimit	(6)	
Drejtor	1	II- b
Inspektor	5	III- a
Drejtoria e Çështjeve Juridike	(5)	
Drejtor	1	II- b
Specialist	4	III- b
Drejtoria e Financave dhe Shërbimeve Mbështetëse	(8)	
Drejtor	1	II- b
Specialist (IT)	1	III- b
Specialist (Marrëdhëniet me Publikun dhe Burimet Njerëzore)	1	III- b
Specialist (Financë/Buxhet)	1	III- b
Specialist Arkivë/Protokoll	1	IV-b
Punonjës Mirëmbajtjeje	1	Vkm 202, dt 15.3.2017
Shofer	1	Vkm 202, dt 15.3.2017
Pastrues	1	Vkm 202, dt 15.3.2017
PUNONJËS GJITHSEJ	37	

**VENDIM
Nr. 92/2022****PËR EMËRIMIN E ZONJËS
MARJANA SEMINI ANËTARE
E GJYKATËS KUSHTETUESE**

Në mbështetje të nenit 125, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 7/c, pika 6, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Emërimin e zonjës Marjana Semini anëtare të Gjykatës Kushtetuese në zbatim të nenit 125, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 7/c, pika 6, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 22.12.2022

**VENDIM
Nr. 93/2022****PËR MOSMIRATIMIN E
KANDIDATURËS SË ZOTIT
ALTIN GOXHAI
PËR AVOKAT TË POPULLIT**

Në mbështetje të nenit 61 të Kushtetutës, të neneve 3, 4 dhe 9 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Mosmiratimin e kandidaturës së zotit Altin Goxhaj në detyrën e Avokatit të Popullit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 22.12.2022

**VENDIM
Nr. 94/2022****PËR MOSMIRATIMIN E
KANDIDATURËS SË ZOTIT
LEDIO BRAHO
PËR AVOKAT TË POPULLIT**

Në mbështetje të nenit 61 të Kushtetutës, të neneve 3, 4 dhe 9 të ligjit nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, me propozimin e një grupi deputetësh,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË****VENDOSI:**

I. Mosmiratimin e kandidaturës së zotit Ledio Braho në detyrën e Avokatit të Popullit.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARE
Lindita Nikolla**

Miraturar në datën 22.12.2022

**VENDIM**

Nr. 895, datë 29.12.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 465, DATË 26.7.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR PËRMIRËSIMIN E NIVELIT TË KONTROLLIT TË MJETEVE MOTORIKE E RIMORKIOVE TË TYRE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 7, e vendimit nr. 465, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Periudha e veprimit të Task-Forcës do të jetë deri më 31 dhjetor 2023.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 896, datë 29.12.2022

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “RISHIKIMI I PROJEKTIT PËR SEGMENTIN RRUGOR TË VAZHDIMIT TË UNAZËS SË MADHE TË TIRANËS NGA SHESHI SHQIPONJA – BULEVARDI I RI” DHE “RIKUALIFIKIMI I UNAZËS LINDORE PËR LOTËT 4, 5, 6” (FAZA 2)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë

private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të Unazës së Madhe të Tiranës nga sheshi Shqiponja - Bulevardi i Ri” dhe “Rikualifikimi i Unazës Lindore për lotët 4, 5, 6” (faza 2).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, “arë”, “ndërtesë social-ekonomike” dhe “objekt banimi”, me një vlerë të përgjithshme prej 143 632 865.70 (njëqind e dyzet e tre milionë e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 143 632 865.70 (njëqind e dyzet e tre milionë e gjashtëqind e tridhjetë e dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë) lekësh, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.



9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Autoriteti Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë

së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku



LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR
“RISHIKIMI I PROJEKTTIT PËR SEGMENTIN RRUGOR TË VAZHDIMIT TË UNAZËS SË MADHE TË TIRANËS NGA SHESHI SHQIPONJA -
BULEVARDI I RI” DHE “RIKUALIFIKIMI I UNAZËS LINDORE PËR LOTET 4, 5, 6” (FAZA 2).

Nr	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadastrale	Numri Pasurisë	Lloji Pasurisë	TOKË ARË				TOKË TRUALL				NDËRTHESË SOC. EK			OBJEKT BANIMI				Vlera totale paraprake (lekë)	SHËNIME
							Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpr. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpr. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpr. (m²)	Vlera sipas preventivit lekë	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpr. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë		
1	Adelina Osman Kokonoz Ahmet Sulejman Kokonoz Bukurije Myslim Saraci Dylbere Sulejman Diodari Edhurat Osman Kokonoz Ermalinda Osman Kokonoz Fathardha Shefqet Mita Hajrije Qazim Kokonoz Iir Shefqet Kokonoz Imekda Sulejman Gjoka Miranda Jakup Derveni Mustafa Jakup Kokonoz Myslim Shefqet Kokonoz Ornela Osman Deliu Skender Jakup Kokonoz Vjollca Ramiz Kokonoz Zera Zenel Kollari			3976	37/1	Arë	42,921.00	7,324.00	448	3,281,152.00												3,281,152.00	Mbi këtë pasuri ndodhet nd 37/1 nd vol 26 fq 73
2	Skënder	Jakup	Kokonoz	3976	37/1 - nd	Ndërtesë				-						487.5	487.50	61,167	29,818,912.5			29,818,912.50	Kjo ndërtesë ndodhet mbi pasurinë nr. 37/1 zik 3976 Presheqimi seksioni E: "L" lag 155, datë 23.02.2021, kati përdhe sip. Ndërtimi 145.1 m2, sip. Verande 17.4 m2, sip banimi 162.5 m2, kati i parë: sip ndërtimi 137.5 m2 sip verande 25 m2 sip banimi 162.5 m2 dhe kati i dytë: sip ndërtimi 137.5 m2 sip verande 25 m2 sip banimi 162.5 m2
3	Halim	Asllan	Lleshi	3976	35/19	Arë	600	600.00	448	268,800.00												268,800.00	
4	Bardhul	Shaqir	Cani	3976	35/20	Arë	530	530.00	448	237,440.00			-							-		237,440.00	
5	Ismail	Qerim	Skeja	3976	35/64	Arë	11.70	11.70	448	5,241.60			-							-		5,241.60	
6	Ismail	Qerim	Skeja	3976	35/62	Truall + Ndërtesë				-	572.7	443.8	479	212,580.20				612.4	612.40	61,167	37,458,670.8	37,671,251.00	Leje leg nr.89158 datë 12.01.2015 Godinë banimi 3 kat + papafingos + 1 kat nentoke Sip. E katit nentoke 43.4 m2, sip e katit përdhe 131.1, sip e katit te pare 156.4m2, sip e katit te dyte 156.4 m2, sip e papafingos 125.1 m2
7	Ismail	Qerim	Skeja	3976	35/63	Arë	25.60	25.60	448	11,468.80			-							-		11,468.80	Pasuria u rivlerësua në shumën 11.200



																							leke me APL 36454 dt 13.09.2021
8	Salë	Osman	Gaxherri	3976	35/39	Atë	284.00	284.00	448	127,232.00				-					-	127,232.00			
9	Sulejman	Baftar	Kurti	3976	35/40	Atë	236.00	236.00	448	105,728.00				-					-	105,728.00			
10	Merita	Kadri	Nikolla	3976	35/8	Atë	330.00	330.00	448	147,840.00				-					-	147,840.00		mbi kete pasuri ndodhet ndertesa me nr 38/8-nd me vol 18 fq 61	
11	Merita	Kadri	Nikolla	3976	35/8-nd	Ndërtesë				-				-	121.60	121.6	809,955.40	128.9	128.90	61,167	7,884,426.3	8,694,381.70	Kjo nd ndodhet mbi pasurite Nr. 35/8, 35/22 (nuk jane zgjidhur mardheniet me trullin) Leje legalizimi 993979, date 31.08.2017 Godine banimi 2 kat + 1 kat nentoke, sip kati nentoke 38.5 m2, sip kati perdhe 78.3 m2, sip verande 12.1 m2 , sip kati pate (Karabina) 121.6 m2
12	Haki	Xhelo	Canollari	3976	35/22	Trull + Ndërtesë				-	250	139.8	479	66,964.20				375.6	375.60	61,167	22,974,325.2	23,041,289.40	1/1 Legalizimi nr.2624427, date 19.07.2017, Godine Banimi 2 kate + 1 Kat nentoke , sip kati nentoke 78.6 m2, sip kati perdhe 119 m2 (nga ku sip verande + shalle 18.9 m2) sip kati pate 119 m2 (sip verande 40.1 m2)
13	Ferdinant	Dervish	Cene	3976	35/17	Atë	200.00	200.00	448	89,600.00				-						-	89,600.00		
14	Salë	Osman	Gaxherri	3976	35/52	Atë	156.00	156.00	448	69,888.00				-						-	69,888.00		
15	Shoqëria Kevuçi shpk			3976	134/8	Atë	2,250.00	64.10	448	28,716.80				-						-	28,716.80	pasuria bllokohet ne favor te union bank per shumen 100,000 euro k. hip nr 2587 exp. nr 812 kol dt 05.04.2019	
16	Jorgo	Xhevat	Biba	3976	35/53	Atë	190.00	33.20	448	14,873.60				-						-	14,873.60	mbi ket pasuri ndodhet ndertesa me nr pas 35/53-nd	
17	Edmond, Emiljano	Puçe, Spiro	Metaj, Nexha	3976	136/401	Trull + Ndërtesë				-	386	386	479	184,894.00	19.40	19.4	726,638.10	253.4	253.40	61,167	15,499,717.8	16,411,249.90	Leje legalizimi 13802, date 12.07.2019, Objekt Banimi 2 Kat, objekt social - ekonomik 1 kat
18	Mira, Algert, Igli	Maliq, Nuredin	Aga Aga Aga	3976	68/23	Atë	350.00	247.00	448	110,656.00				-						-	110,656.00		
19	Veladin	Nuredin	Balla	3976	136/50	Atë	400.00	243.60	448	109,132.80				-						-	109,132.80		
20	Ramazan	Rexhep	Pupuleku	3976	136/49	Atë	570.00	570.00	448	255,360.00				-						-	255,360.00		
21	Flogert Elton	Shyqyr Shyqyr	Sulejmani Sulejmani	3976	136/375	Trull + Ndërtesë				-	354.7	77	479	36,883.00						-	36,883.00	leje legalizimi nr 2624531 dt 02.03.2018 godine banimi 3 kt kt perdhe 84.3 m2, kt pate 102.6 m2, kt dyte 102.6m2	
22	Andri	Agim	Kuçi	3976	68/19	Atë	430.00	430.00	448	192,640.00				-						-	192,640.00		



23	Lulezim	Hatem	Duro	3976	136/365	Truall + Ndërsesë		-	223.1	11.2	479	5,364.80							-	5,364.80	kije legalizimi nr 997/410 dt 09.05.2017 godine banimi 2 kt 1 kt mentike= 47.5m2, k perdfbe 86.1 m2 & pure 104m2		
24	Fatmir	Ismail	Karaj	3976	134/9	Atë	320.00	17.00	448	7,616.00		-							-	7,616.00			
25	Shoqëria Kevuçi shpk			3976	134/7	Atë	3,050.00	186.10	448	83,372.80		-							-	83,372.80	hipotekë ligjore se kredite se dhene nga institucionet bankare		
26	Ismail	Kasem	Spaja	3976	68/32	Atë	5,711.00	1,072.30	448	480,390.40		-							-	480,390.40	Mbës këtë pasuri pozicionohet nd nr 68/32-nd1 , 68/32-nd, 68/9-nd1		
27	Kujtim	Xhemal	Picalli	3976	68/25	Atë	202.00	202.00	448	90,496.00		-							-	90,496.00			
28	Hajri	Gani	Dauti	3976	68/17	Atë	311.00	192.50	448	86,240.00		-							-	86,240.00			
29	Ibrahim	Kasem	Spaja	3976	129/27	Atë	641.20	83.80	448	37,542.40		-							-	37,542.40			
30	Mehmet	Islam	Balashi	3976	129/13	Atë	435.00	435.00	448	194,880.00		-							-	194,880.00			
31	Shpresa Hysni Enkelejdë Arta Violeta	Halit Refik Refik Refik	Sina Sina Bekteshi Anapi Ajro	8170	5/426	Truall		-	292.6	56.3	32878	1,851,031.40							-	1,851,031.40	Leje Legalizimi nr 9087 dt 26.03.2012 godine banimi 1 kt , kati perdfbe 95.1		
32	Gëzim	Mustafa	Laci	8170	5/321	Truall + Ndërsesë		-	300	161.4	32878	5,306,509.20					101	101.00	95,397	9,635,097.0	14,941,606.20	Vendimi nr 234, date 27.10.2021 Per miratimin e kërkeses për kalimi në pronësi të objektit pa titull pronësi me truallin funksional	
33	Mustafa	Ibrahim	Avdiu	8110	7/66	Truall + Nd																	
	Vlera Totale						59,012.80	13,473.90		6,036,307.20	2,789.60	1,491.70		12,788,815.40	141.00	141.00	1,536,593.50	1,958.80	1,958.80		123,271,149.60	143,632,865.70	

**VENDIM****Nr. 897, datë 29.12.2022****PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË
MENJËHERSHME TË PENSIONISTËVE
PËR ZBUTJEN E IMPAKTIT TË KRIZËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbështetje financiare të menjëhershme të pensionistëve, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë, për zbutjen e impaktit të krizës, sipas kategorive të mëposhtme:

a) personat, që përfitojnë pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

b) personat, që përfitojnë pension, sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

c) personat, që përfitojnë pension sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, personat që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”, të ndryshuar, dhe personat, që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar;

ç) personat, që përfitojnë pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit,

të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

d) personat, që nuk përfitojnë pension, por që trajtohen vetëm me shpërblimin financiar si veteranë të LANÇ-it, sipas vendimit nr. 190, datë 3.5.1995, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7874, datë 17.11.1994, “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar””, si dhe personat, të cilët marrin vetëm pension të posaçëm për merita të veçanta, sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”;

dh) personat, që nuk përfitojnë pension, por që përfitojnë vetëm pension shtetëror të posaçëm, të caktuar në përputhje me nenin 5, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

e) personat, që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit të veçantë financiar, sipas neneve 5/1/a ose 5/1/b, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;

ë) personat, që nuk përfitojnë pension nga ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, por përfitojnë pension suplementar të caktuar, sipas ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar;

f) personat, që përfitojnë pension për shkak të profesionit të vështirë, sipas nenit 5, të ligjit nr. 29/2019, “Për trajtimin financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”;

g) personat, që nuk përfitojnë pension, por janë përfitues vetëm të trajtimit financiar si fëmijë në përkujdesje të Republikës, sipas ligjit nr. 129/2021, “Për statusin fëmijë në përkujdesje të Republikës”.



2. Të drejtën për të përfituar shpërblimin, në masën e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, e kanë edhe ata persona që kanë datë të fillimit të përfitimit deri në datën 31.12.2022, duke përfshirë edhe këtë datë, dhe kanë të drejtë të marrin vetëm një herë këtë shpërblim pavarësisht se mund të përfitojnë më shumë se një përfitim.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 5 605 294 000 (pesë miliardë e gjashtëqind e pesë milionë e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë), e ndarë në 5 560 808 000 (pesë miliardë e pesëqind e gjashtëdhjetë milionë e tetëqind e tetë mijë) lekë për shpërblimin dhe 44 486 000 (dyzet e katër milionë e katërqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë) lekë shpenzime administrative për dhënien e shpërblimit. Efektet financiare do të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit, miratuar për vitin 2022.

4. Shpërblimet kalohen në llogaritë e pensionistëve në muajin dhjetor 2022 dhe paguhen gjatë këtij muaji. Në rastet kur pagesat efektive nuk kryhen brenda muajit dhjetor 2022, ato të paguhen gjatë vitit të ardhshëm. Shpërblimet e patërhequra parashkruhen me kalimin e 36 muajve nga data e miratimit të këtij vendimi.

5. Administrimi i fondeve buxhetore të shpërblimit të pensionistëve, caktimi i shpërblimit për çdo përfitues dhe pagesa realizohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Posta Shqiptare sh.a., dhe bankat e nivelit të dytë, sipas të njëjtave procedura që zbatohen për administrimin e fondit të sigurimeve shoqërore.

6. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore, të cilët autorizohen të kryejnë edhe rialokimin e fondeve, sipas programeve në buxhetin e sigurimeve shoqërore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 898 , datë 29.12.2022

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË MENJËHERSHME TË PUNONJËSVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES SË PËRGJITHSHME DHE INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË PUBLIK PËR ZBUTJEN E IMPAKTIT TË KRIZËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbështetjen financiare të menjëherëshme të punonjësve të njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe institucioneve të arsimit të lartë publik (IALP) për zbutjen e impaktit të krizës.

2. Në kuptim të këtij vendimi, njësi të qeverisjes së përgjithshme janë tërësia e njësive të qeverisjes qendrore, vetëqeverisjes vendore dhe të fondeve speciale.

3. Masat e mbështetjes financiare të menjëherëshme jepen, si më poshtë vijon:

a) Në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë, ku përfshihen punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe IALP-ve, me pagë bruto nën 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, si dhe kategoritë e mëposhtme:

i. punonjësit e policisë në strukturat e RENE-s, FNSH-së, DELTA-s dhe të strukturës së posaçme operacionale;

ii. punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;

iii. punonjësit e strukturës së Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë.

b) Në masën 10 000 (dhjetë mijë) lekë, ku përfshihen punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme dhe IALP-ve, me pagë bruto mbi 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë.

4. Përfshihen nga përcaktimet e pikës 3 institucionet e rivlerësimit kalimtar të magistratëve, efektet financiare të të cilëve përballohen brenda buxhetit të miratuar për këto institucione, për vitin 2022.



5. Nga kjo mbështetje financiare e menjëhershme përjashtohen stafet politike dhe personat e zgjedhur të qeverisjes qendrore dhe vetëqeverisjes vendore.

6. Efektet financiare të pikës 1, të këtij vendimi, përballohen, si më poshtë vijon:

a) për çdo njësi të qeverisjes qendrore, për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit dhe punonjësit arsimorë/edukatorë të transferuar nga pushteti qendror në pushtetin vendor nga shpenzimet korrente, të miratuara për çdo njësi në buxhetin e vitit 2022, si dhe nga fondi rezervë i buxhetit, për vitin 2022;

b) për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetet përkatëse, për vitin 2022;

c) për njësitë e fondeve speciale nga shpenzimet korrente, të miratuara në buxhetin përkatës, për vitin 2022;

ç) për IALP-të nga buxhetet përkatëse, për vitin 2022.

7. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për shpërndarjen e fondeve të nevojshme nga fondi rezervë i buxhetit, për vitin 2022, për të përballuar efektet financiare për institucionet e përfshira në shkronjën “a”, të pikës 6, të këtij vendimi, në rast se fondi nga shpenzimet korrente në dispozicion nuk është i mjaftueshëm.

8. Ngarkohen njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe IALP-të të kryejnë veprimet financiare, deri më datë 10 janar 2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 899, datë 29.12.2022

**PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË
DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR
ZBUTJEN E IMPAKTIT TË KRIZËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të

ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar u jepet mbështetje financiare e menjëhershme për zbutjen e impaktit të krizës, sipas kategorive të mëposhtme:

a) familje me gra kryefamiljare, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, në masën 20 000 (njëzet mijë) lekë;

b) familjet e tjera, të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë;

c) familje, të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas shkronjave “b” dhe “c”, të nenit 8, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë;

ç) individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë;

d) individët përfitues të statusit, sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, në masën 8 000 (tetë mijë) lekë.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 1 160 400 000 (një miliard e njëqind e gjashtëdhjetë milionë e katërqind mijë) lekë dhe përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2022.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDESKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



**BIBLIOGRAFIA E INFORMACIONIT TË
DEKLASIFIKUAR
“SEKRET SHETETËROR” NË
DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË
ARKIVAVE**

Bazuar në ligjin nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar ‘Sekret shtetëror’”, i ndryshuar, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 15.11.2017, “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar ‘Sekret Shtetëror’”, Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, i mbledhur më datë 16.12.2022, vendosi të deklasifikojë informacionet e klasifikuara “Sekret shtetëror”, si më poshtë:

1. Deklasifikohen plotësisht informacionet (dosjet) e klasifikuara “Sekret shtetëror” si më poshtë:

Fondi 14/APSTR, viti 1987

Dosjet nr. 346, 347, 348, 349, 350, 351, 352, 353, 354, 355, 356, 357, 359, 360, 361, 362, 363, 364, 365. Niveli i klasifikimit, “Sekret”. Dosja nr. 366. Niveli i klasifikimit, “T Sekret”. Dosjet nr. 367, 368, 370, 371, 372, 373, 374, 375, 376, 377, 378, 379, 380, 381, 382, 383, 384, 385, 386, 387, 388, 394, 395, 396, 397, 399, 400, 401, 402, 403, 405, 406, 407, 409, 410, 411, 412, 413, 415, 416, 417, 418, 421, 422, 423, 424, 425, 428, 429, 434, 441, 444, 445, 447, 450, 451, 452, 453, 454, 455, 456, 457, 458, 459, 460, 461, 462, 463, 464, 465, 466, 467, 468, 469, 470, 471, 473, 474, 475, 476, 477, 478, 479, 480, 481, 482, 483, 484, 485, 486, 497, 500, 501, 504, 506, 514, 524, 525, 530, 532, 533, 537, 546, 553, 554, 558, 561. Niveli i klasifikimit, “Sekret”. Dosja nr. 564. Niveli i klasifikimit, “T Sekret”. Dosjet nr. 570, 580, 586, 598, 601, 602, 605, 609, 632, 634, 635, 636, 637, 638, 639, 640, 641, 642, 646. Niveli i klasifikimit, “Sekret”.

2. Një kopje e bibliografisë t’i dërgohet DSIK, si dhe për botim në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Ardit Bido**

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 80 lekë